# Republika e Kosovës
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) Nr. 01/2021**
**PËR CAKTIMIN E TARIFAVE DHE KOMISIONEVE PËR AKREDITIM DHE SHËRBIMEVE TJERA TË OFRUARA NGA DAK**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MTI) NO. 01/2021**
**ON SETTING UP TARIFFS AND FEES FOR ACCREDITATION AND OTHER SERVICES OFFERED BY DAK**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MTI) Br. 01/ 2021**
**O ODREĐIVANJU TARIFA I PROVIZIJA ZA AKREDITACIJU I OSTALE USLUGE KOJE PRUŽA DAK**

| **MINISTRI I MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRISË** | **MINISTER OF MINSTRY OF TRADE AND INDUSTRY** | **MINISTAR MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE** |
|---|---|---|
| Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në Prishtinë me Nr. 2 datë 12 Janar 2017, nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe shtojcës 13 të Rregullores Nr. 06/2020 "Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive", nxjerr: | Pursuant to article 11- paragraph 2 of the Law No. 05/L-117 On accreditation, Official Gazette No. 2 / 12 January 2017 article 38 paragraf 6 of the Regulation No. 09/2011 on Rules and Procedure of the Government of the Republic of Kosovo, article 8 paragraph 1 sub-paragraph 1.4 and Annex 13 of the Regulation No.06/2020 On the Areas of Administrative Responsibility of Prime Minister's Office and Ministries, issues: | Ministarstvo Trgovine i Industrije na osnovu člana 11 stav 2 Zakona Br. 05/L - 117 O Akreditaciji obavljen u Službeni List Republike Kosovo u Prištini Br. 2/12 Januar 2017, člana 38 stava 6 Pravilnika Br. 9/2011 o Radu Vlade Republike Kosovo, člana 8 stav 1 i podstav 1.4 i Aneksa 13 Pravilnika Br.06/2020 O Oblastima Administrativne Odgovornosti Ureda Premijera i Ministarstava, donosi: |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) Nr. 01/2021 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE DHE KOMISIONIEVE PËR AKREDITIM DHE SHËRBIMEVE TJERA TË OFRUARA NGA DAK** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MTI) NO. 01/2021 ON SETTING UP TARIFFS AND FEES FOR ACCREDITATION AND OTHER SERVICES OFFERED BY DAK** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MTI) br. 01/ 2021 O ODREĐIVANJU TARIFA I PROVIZIJA ZA AKREDITACIJU I OSTALE USLUGE KOJE PRUŽA DAK** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**Purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen tarifat dhe komisionet për shërbimet të cilat i ofron Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës, në tekstin e mëtejmë DAK. Tarifat | This Administrative Instruction determines the tariffs and the fees for the services offered by the Kosovo General Accreditation Directorate, hereinafter referred to as DAK. The tariffs and | Ovo Administrativno Uputstvo određuje tarife i provizije za usluge koje pruža Generalna Direkcija Kosova za Akreditaciju, u daljem tekstu DAK. Tarife i provizije su iste za |

| | | |
|---|---|---|
| dhe komisionet janë të njejta për subjektet vendore dhe ato të jashtme që veprojnë në Republikën e Kosovës. | fees are the same for local entities or foreign ones operating in the Republic of Kosovo. | domaće i strane subjekte koji posluju u Republici Kosovo. |
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Delokrug** |
| Ky Udhëzim Administrativ është i zbatueshëm për trupat për vleresim të konformitetit, në tekstin e mëtejmë TVK, që aplikojnë për akreditim, ato që janë të akredituara si dhe për personelin e TVK-ve dhe të DAK-së. | This Administrative Instruction applies to conformity assessment bodies, hereinafter referred to as CAB, that apply for accreditation, those who are accredited as well as to CAB's and DAK's staff. | Ovo Administrativno Uputstvo primenljivo je na Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti, u daljem tekstu TOU, koja apliciraju za akreditaciju, one koji su akreditovani, kao i na osoblje TOU-a i DAK-a. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Definicije** |
| 1. Termat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ e kanë këtë kuptim: | 1. The terms used in this Administrative Instruction have the following meaning: | 1. Izrazi korišćeni u ovom Administrativnom Uputstvu imaju sledeči značaj: |
| **1.1. Vlerësues/e** – person i emëruar nga DAK për të kryer, i vetëm ose në kuadër të një ekipi vlerësues, një vlerësim të një trupi për vlerësim të konformitetit. | **1.1. Assessor** – person assigned by DAK to perform, alone or as part of an assessment team, an assessment of a conformity assessment body. | **1.1. Ocenjivač** – lice imenovano od strane DAK da sprovodi, sam ili u okviru ocenjivačke ekipe, ocenjivanje tela za ocenjivanje usaglašenosti. |
| **1.2. Udhëheqës/e i/e ekipit** – vlerësues të cilit i është dhënë përgjegjësia e përgjithshme për menaxhimin e një vlerësimi. | **1.2. Team leader** – assessor who is given the overall responsibility for the management of an assessment. | **1.2. Vođa tima** – ocenjivač kome je data celokupna odgovornost za upravljanje ocenjivanja. |

| | | |
|---|---|---|
| **1.3. Ekspert/e teknik/e** – person i emëruar nga DAK që punon nën përgjegjësinë e një vlerësuesi ose vlerësuesi teknik, e i cili ofron njohuri ose ekspertizë specifike për fushën e akreditimit që vlerësohet dhe nuk bën vlerësim në mënyrë të pavarur. | **1.3. Technical Expert** – person assigned by DAK, working under the responsibility of an assessor or technical assessor, who provides specific knowledge or expertise with respect to the scope of accreditation to be assessed and does not assess independently. | **1.3. Tehnički ekspert** - lice imenovano od strane DAK koje radi pod odgovornošću ocenjivača ili tehničkog ocenjivaća, koje pruža specifična znanja ili stručnost za oblast akreditacije koja se ocenjuje i koja ne sprovodi nezavisno ocenjivanje. |
| **1.4.Vlerësues/e teknik/e** – vlerësues, zakonisht i jashtëm, i emëruar nga DAK për vlerësim të kompetencës teknike të një trupi për vlerësim të konformitetit për fushën e akreditimit që vlerësohet. | **1.4. Technical Assessor** – assessor, usually external, assigned by DAK for assessment of the technical competence of a conformity assessment body with respect to the scope of accreditation to be assessed. | **1.4. Tehnički ocenjivać** – ocenjivač, obično spoljni, imenovan od strane DAK za ocenjivanje tehničke kompetentnosti tela za ocenjivanje usaglašenosti za oblast akreditacije koja se ocenjuje. |
| **Neni 4**<br>**Tarifat dhe komisionet** | **Article 4**<br>**Tariffs and fees** | **Ćlan 4**<br>**Tarife i provizije** |
| 1. Tarifat dhe komisionet e DAK-së për shërbimet e akreditimit janë: | 1. The tariffs and fees charged by DAK for its accreditation services are: | 1. Tarife i provizije DAK-a za usluge akreditacije su: |
| 1.1. Aplikimi për akreditim ............. 50 €; | 1.1. Application for accreditation ......... 50 € | 1.1.Apliciranje za akreditaciju.....50€; |
| 1.2 Aplikimi për zgjërim të fushës ... 20 €; | 1.2 Application for scope extension .. 20 €; | 1.2. Apliciranje za proširenje oblasti....20€; |
| 1.3 Aplikimi për ri-vlerësim (ri-akreditim) .................................... 30 €; | 1.3 Application for re-assessment (re-accreditation) ....…...................... 30 €; | 1.3. Prijava za ponovno ocenjivanje (Reakreditacija)............30€; |
| 1.4 Udhëheqësi i ekipit ............ 110 €/ditë; | 1.4 Team leader ................. 110 €/day; | 1.4. Vođa tima........................110€/dan; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5 Vlerësuesi teknik ................ 90 €/ditë; | 1.5 Technical assessor ................. 90 €/day; | 1.5. Tehnički ocenjivaća..........90 €/dan; |
| 1.6 Eksperti teknik ................... 70 €/ditë; | 1.6 Technical expert …................ 70 €/day; | 1.6. Tehnički ekspert................70€/dan; |
| 1.7 Vlerësuesi ........................... 50 €/ditë; | 1.7 Assessor ............................ 50 € / day; | 1.7. Ocenjivać..................50€/dan; |
| 1.8 Vendimi për akreditim dhe lëshimi i certifikatës së akreditimit .............. 100 €; | 1.8 Accreditation decision and issue of the accreditation certificate ................... 100 €; | 1.8.Odluka o akreditaciji i izdavanje sertifikata o akreditaciji..................100€. |
| 1.9 Tarifa vjetore për: | 1.9 Annual fee for: | 1.9. Godišnja tarifa za: |
| 1.9.1 Laborator testues/kalibrues me 1 deri 25 metoda të akredituara ..... 200 €/vit; | 1.9.1 Testing/calibration laboratory with 1 to 25 accredited methods ……. 200 €/year; | 1.9.1.Laboratorija za ispitivanje/ kalibraciju sa 1 do 25 akreditovanih metoda ..........200€ godišnje; |
| 1.9.2 Laborator testues/kalibrues me 26 deri 50 metoda të akredituara ......... 300 €/vit; | 1.9.2 Testing/calibration laboratory with 26 to 50 accredited methods .. 300 € / year; | 1.9.2.Laboratorija za ispitivanje/ kalibraciju sa 26 do 50 akreditovanih metoda ........300€/godišnje; |
| 1.9.3 Laborator testues/kalibrues me mbi 50 metoda të akredituara ..... 400 €/vit; | 1.9.3 Testing/calibration laboratory with over 50 accredited methods .. 400 € / year; | 1.9.3.Laboratorija za ispitivanje/ kalibraciju sa preko 50 akreditovanih metoda ........400€/godišnje; |
| 1.9.4 Laborator mjekësor me 1 deri 25 metoda të akredituara .......... 400 €/vit; | 1.9.4 Medical laboratory with 1 to 25 accredited methods …........... 400 € / year; | 1.9.4.Medicinska laboratorija sa 1 do 25 akreditovanih metoda ....400€/godišnje; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.9.5 Laborator mjekësor me 26 deri 50 metoda të akredituara ..... 500 €/vit;<br><br>1.9.6 Laborator mjekësor me mbi 50 metoda të akredituara .......... 600 €/vit;<br><br>1.9.7 Trup inspektues me 1 deri 5 metoda të akredituara .......... 500 €/vit;<br><br>1.9.8 Trup inspektues me mbi 5 metoda të akredituara .......... 700 €/vit;<br><br>1.9.9 Trup certifikues për produkte për 1 deri 10 produkte/grupe të produkteve ........................... 500 €/vit;<br><br>1.9.10 Trup certifikues për produkte për më shumë se 10 produkte/grupe të produkteve ........................... 700 €/vit;<br><br>1.10 Pjesëmarrja në trajnime të ofruara nga DAK .............. 30 €/ditë/person; | 1.9.5 Medical laboratory with 26 to 50 accredited methods ............... 500 € / year;<br><br>1.9.6 Medical laboratory with over 50 accredited methods …........... 600 € / year;<br><br>1.9.7 Inspection body with 1 to 5 accredited methods .............. 500 € / year;<br><br>1.9.8 Inspection body with over 5 accredited methods .............. 700 € / year;<br><br>1.9.9 Certification body for products for 1 to 10 products/product groups 500 €/year;<br><br>1.9.10 Certification body for products for over 10 products/product groups ............................................... 700 €/year;<br><br>1.10 Participation in trainings offered by DAK ...................... 30 €/day/person; | 1.9.5.Medicinska laboratorija sa 26 do 50 akreditovanih metoda .....500€/godišnje;<br><br>1.9.6. Medicinska laboratorija sa preko 50 akreditovanih metoda .....600€/godišnje;<br><br>1.9.7.Inspekcijsko telo sa 1 do 5 akreditovanih metoda ..........500€/godišnje;<br><br>1.9.8.Inspekcijsko telo sa preko 5 akreditovanih metoda ..........700€/godišnje;<br><br>1.9.9.Sertifikaciono telo za proizvode za 1 do 10 proizvoda/grupe proizvoda ........500€/godišnje;<br><br>1.9.10.Sertifikaciono telo za proizvode za preko 10 proizvoda/grupa proizvoda ................700€/godišnje;<br><br>1.10.Učešće u obukama koje pruža DAK ..................30€/dan/osoba; |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 5**<br>**Shërbimet e përfshira në tarifa dhe komisione** | **Article 5**<br>**Services included in the tariffs and fees** | **Ćlan 5**<br>**Usluge uključene u tarife i provizije** |
| 1. Komisionet 1.1 deri 1.3 nga paragrafi 1 i nenit 4 të këtij Udhezimi Administrativ i përfshijnë aktivitetet si: shqyrtimin e aplikacionit, shqyrtimin e burimeve si dhe aktivitetet tjera për fillimin e procedurave të akreditimit, zgjerimit të fushës ose riakreditimit. | 1. Fees 1.1 to 1.3 from paragraph 1 of article 4 of this Administrative Instruction include activities such as: application review, resources review as well as other activities for the commencement of the procedures for accreditation, scope extension or re-accreditation. | 1. Provizije od 1.1 do 1.3 iz stava 1 člana 4 ovog Administrativnog Uputstva uključuju aktivnosti kao što su: pregled aplikacija, pregled resursa i druge aktivnosti za pokretanje postupaka akreditacije, proširenje obima ili ponovnu akreditaciju. |
| 2. Tarifat 1.4 deri 1.7 nga paragrafi 1 i nenit 4 i përfshijnë: | 2. Tariffs 1.4 to 1.7 from paragraph 1 of article 4 include: | 2.Tarife od 1.4 do 1.7 iz stava 1 člana 4 uključuju: |
| 2.1 shqyrtimin e informatave të dokumentuara të dorëzuara nga TVK, | 2.1 review of documented information submitted by CAB, | 2.1 pregled dokumentovanih informacija koje je podneo TOU, |
| 2.2 realizimin e vizitës preliminare / vlerësuese / mbikëqyrëse / të jashtëzakonshme përfshirë udhëtimin nga zyra e DAK-së te TVK dhe anasjelltas, | 2.2 performance of preliminary / assessment / surveillance / extraordinary visit including travel from DAK's office to CAB's premises and back, | 2.2 Sprovođenje preliminarne / ocenjivaćke / nadzorne / vanredne posete, uključujući putovanje od kancelarije DAK-a do TOU i obrnuto, |
| 2.3 hartimin e raportit të vlerësimit, | 2.3 drafting the assessment report, | 2.3 izrada izveštaja o ocenjivanju, |
| 2.4 rishikimin e analizës së rrënjës së shkakut të jo-konformiteteve të identifikuara, të veprimeve specifike të | 2.4 review of the route couse analysis of identivied nonconformities, of the specific actions taken or planned to be taken by the | 2.4 pregled analize osnovnog uzroka identifikovanih neusaglašenosti, specifićnih radnji koje je TOU preduzeo ili planira da |

| | | |
|---|---|---|
| ndërmarra ose të planifikuara të ndërmerren nga TVK për zgjidhjen e jo-konformiteteve dhe efektivitetin e zbatimit të tyre brenda afateve të dakorduara. | CAB to resove the nonconformities and the effectiveness of their implementation within the agreed timeframe. | preduzme radi rešavanja neusaglašenosti i efikasnosti njihove primene u dogovorenim rokovima. |
| 3. Numri i ditëve të vlerësimit dhe personelit të përfshirë në vlerësim përcaktohet sipas dokumentit të DAK-së: Politika mbi vlerësimin DAK-PO-02. | 3. The number of assessment days and of staff involved in the assessment is determined according to the DAK document: Policy on Assessment DAK-PO-02. | 3.Broj dana ocenjivanja i osoblje uključeno u ocenjivanju utvrđuje se prema dokumentu DAK-a: Politika ocenjivanja DAK-PO-02. |
| 4. Shpenzimet për vizitat e jashtëzakonshme mbulohen nga TVK nëse vizita rezulton me një ose disa jo-konformitete ose kur ka pasur ndryshime të aspekteve të rëndësishme të menaxhimit të TVK-së siç janë: statusi juridik, vendndodhja, burimet etj. | 4. Costs for extraordinary visits are covered by the CAB if the outcome of the visit is one or several non-conformities or when there have been changes of important management aspects of CAB such as: legal status, location, resources, etc. | 4.Troškove za vanredne posete snosi TOU ako poseta rezultira jednom ili više neusaglašenosti ili kada je došlo do promena u važnim aspektima upravljanja TVK kao što su: pravni status, lokacija, resursi itd. |
| 5. Tarifat 1.4 deri 1.7 nga paragrafi 1 i nenit 4 zbatohen për vlerësuesit / ekspertet vendor. Për të huajt zbatohen tarifat e vendit të origjinës së tij/saj. | 5. Tariffs 1.4 to 1.7 from paragraph 1 of article 4 apply to local assessors / experts. For foreigners the tariffs of their country of origin apply. | 5. Tarife 1.4 do 1.7 iz stava 1 člana 4 primenjuju se na domaće ocenjivaće/eksperte. Za strance se primenjuju tarife prema zemlji porekla. |
| 6. Komisioni 1.8 nga paragrafi 1 i nenit 4 i përfshin aktivitetet si: shqyrtimin e dosjes nga Këshilli i Akreditimit, marrjen e vendimit për akreditim dhe aktivitetet tjera administrative të parapara me dokumentin e DAK-së: Procedura e Akreditimit DAK-PT-01 përfshirë edhe | 6. Fee 1.8 from paragraph 1 of article 4 includes activities such as: review of the file by the Accreditation Council, making the decision on accreditation and other administrative activities as foreseen by the DAK document: Procedure on Accreditation DAK-PT-01 | 6. Provizija 1.8 iz stava 1 člana 4 uključuje aktivnosti kao što su: pregled spisa od strane Saveta za Akreditaciju, donošenje odluke za akreditaciju i druge administrativne aktivnosti predviđene dokumentom DAK-a: Postupak Akreditacije DAK-PT-01, uključujući izradu |

| | | |
|---|---|---|
| draftimin e certifikatës së akreditimit dhe aneksit të tij.<br><br>7. Tarifat vjetore 1.9.1 deri 1.9.10 nga paragrafi 1 i nenit 4 i përfshijnë aktivitetet si: përdorimin e simbolit të akreditimit nga TVK, promovimin e akreditimit dhe TVK-ve të akredituara, ofrimin e informacionit për TVK-të për zhvillimet e reja në fushën e akreditimit, përgatitjen dhe sigurimin e dokumenteve relevante.<br><br>8. TVK duhet t'i parapaguaj tarifat vjetore. Tarifa e parë paguhet me rastin pranimit të certifikatës së akreditimit nga DAK ndërsa për tri vitet e ardhshme tarifat vjetore paguhen më së voni para përvjetorëve të datës së akreditimit e përcaktuar në certifikatën e akreditimit. TVK duhet të dërgojë një kopje të pagesës në DAK jo më vonë se tri ditë pune nga data e fundit e detyrimit për pagesë qoftë në formë fizike apo elektronike. Nëse tarifa vjetore nuk paguhet as edhe brenda një muaji të plotë nga data e lartcekur, akreditimi pezullohet deri sa: të kryhet pagesa e tarifës vjetore, dëshmia e pagesës të pranohet nga | including drafting of the accreditation certificate and its annex.<br><br>7. Annual fees 1.9.1 to 1.9.10 from paragraph 1 of article 4 include activities such as: use of accreditation symbol by CAB, promotion of accreditation and accredited CABs, provision of information for CAB for new developments in the field of accreditation, preparation and provision of relevant documents.<br><br>8. CAB must pay the annual fees in advance. The first fee is paid upon receipt of the accreditation certificate from DAK while for the next three years the annual fees are paid latest before the anniversaries of the accreditation date stated on the accreditation certificate. The CAB must send a copy of the payment to DAK no later than three working days from the last date of the payment obligation either in hard copy or electronically. If the annual fee is not paid even within a full month from the above mentioned date, the accreditation is suspended until: the payment of the annual fee is made, payment proof is | sertifikata o akreditaciji i njegovog aneksa.<br><br>7. Godišnje tarife 1.9.1 do 1.9.10 iz stava 1 člana 4 uključuju aktivnosti kao što su: korišćenje simbola akreditacije od strane TOU, promocija akreditacije i akreditovanih TOU, pružanje informacija o TOU za nova razvijanja u oblasti akreditacije, pripremi i pružanju relevantnih dokumenata.<br><br>8. TOU treba da preplati godišnje tarife. Prva tarifa se plaća po prijemu sertifikata o akreditaciji od strane DAK, dok se u naredne tri godine godišnje tarife plaćaju pre godišnjica datuma akreditacije navedenih u sertifikatu o akreditaciji. TOU treba da pošalje kopiju uplate DAK-u najkasnije u roku od tri radna dana od poslednjeg datuma obaveze plaćanja u fizičkom ili elektronskom obliku. Ako se godišnja tarifa ne plati ni u roku od punih mesec dana od gore navedenog datuma, akreditacija se suspenduje sve dok: godišnja tarifa se uplati, DAK prihvati dokaz o uplati, i |

| | | |
|---|---|---|
| DAK, dhe vendimi i pezullimit të anulohet nga DAK.<br><br>9. Tarifa 1.10 nga paragrafi 1 i nenit 4 e mbulon trajnimin, materialet e trajnimit, logjistikën e nevojshme për realizimin e trajnimit dhe lëshimin e certifikatës së trajnimit.<br><br>**Neni 6**<br>**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**<br><br>Pagesa e obligimeve të tarifave vjetore të mbetura para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ do të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2018 Për caktimin e tarifave për akreditim.<br><br>**Neni 7**<br>**Dispozitat shfuqizuese**<br><br>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2018 Për caktimin e tarifave për akreditim. | received by DAK, and the suspension decision is canceled by DAK.<br><br>9. Fee 1.10 from paragraph 1 of article 4 covers the training, the training materials, the logistics needed to deliver the training and the issuance of the training certificate.<br><br>**Article 6**<br>**Transitional and final provisions**<br><br>Payment of the annual fees due before the entry into force of this Administrative Instruction, shall be made according to the Administrative Instruction No. 03/2018 On setting the fees for accreditation.<br><br>**Article 7**<br>**Repealing provisions**<br><br>By entering into force of this Administrative Instruction, the Administrative Instruction No. 03/2018 On setting up accreditation tarrifs, shall be repealed. | odluka o suspenziji je poništena od strane DAK-a.<br><br>9. Tarifa 1.10 iz stava 1 člana 4 uključuje obuku, materijal za obuku, logistiku neophodnu za realizaciju obuke i izdavanje sertifikata o obuci.<br><br>**Ćlan 6**<br>**Prelazne i završne odredbe**<br><br>Isplata obaveza preostalih godišnjih tarifa pre stupanja na snagu ovog Administrativnog Uputstva izvršiće se u skladu sa Administrativnim Uputstvom br. 03/2018 O Određivanju Tarifa za Akreditaciju.<br><br>**Ćlan 7**<br>**Odredbe ukidanja**<br><br>Stupanjem na snagu ovog Administrativnog Uputstva, ukida se Administrativno Uputstvo br. 03/2018 o Određivanju Tarifa za Akreditaciju. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 8**<br>**Hyrja në Fuqi** | **Article 8**<br>**Entry into Force** | **Ćlan 8**<br>**Stupanje u snagu** |
| 1. Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. | 1. This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after being published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. | 1. Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od objavljivanja u Službenom Listu Republike Kosovo. |
| **Vesel KRASNIQI**<br>_________________<br>**Ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë** | **Vesel KRASNIQI**<br>_________________<br>**Minister of the Ministry of Trade and Industry** | **Vesel KRASNIQI**<br>_________________<br>**Ministar Ministarstva Trgovine i Industrije** |
| Prishtinë, 19.03.2021 | Prishtina, 19.03.2021 | Priština, 19.03.2021 |